

DHJETOR, 2024

RAPORTI MUJOR

METODOLOGJIA

Iniciativa e Re Sociale (NSI) po kryen monitorimin e mediave online dhe mediave sociale në bashkëpunim me Pikasa Analytics INC, një kompani e analitikës së të dhënave e specializuar në zhvillimin dhe zbatimin e mjeteve, softuerëve dhe algoritmeve të mësimit të makinerive. Mjeti ua mundëson monitoruesve të numërojnë numrin nominal të artikujve për tema të caktuara dhe të shohin nivelin e angazhimit të audiencës.

Angazhimet në uebsajte përcaktohen si artikuj të lajmeve që janë shpërndarë në Facebook nga uebsajti i çdo burimi dhe numri total i pëlqimeve, shpërndarjeve dhe komenteve që janë grumbulluar. Angazhimet në mediat sociale përfshijnë pëlqimet, shpërndarjet dhe komentet e mbledhura nga të gjitha kanalet e mediave sociale (Facebook, Instagram, YouTube, TikTok, LinkedIn) për të gjitha postimet, duke përfshirë fotot, videot dhe tekstin. Vlerësimi i angazhimit shtrihet përtej organeve të mediave për të përfshirë një sërë llogarish të mediave sociale përfshirë ato të politikanëve dhe opinionbërësve.

Mjeti grumbullon artikuj dhe ekipi monitorues i NSI-së i shqyrton ato për të identifikuar dezinformimin e mundshëm dhe çrregullimet tjera informative. Sidoqoftë, mjeti ka disa kufizime. Është i përshtatur, me monitorë Pikasa dhe NSI të zgjedhur me kujdes për çdo llogari të vëzhguar. Rrjedhimisht, numri i përgjithshëm i postimeve dhe artikujve përfshin vetëm llogaritë e vëzhguara, duke përjashtuar llogaritë e tjera që gjithashtu mund të postojnë lajme. Llogaritja e angazhimit përbëhet nga të gjitha aksionet, komentet dhe ndërveprimet e tjera.

Për më tepër, llogaritë private mund të vëzhgohen vetëm nëse përcaktohen zyrtarisht si llogari të liderëve politikë ose faqe fansash. Për rrjedhojë, disa llogari të politikanëve në Facebook mund të mos përfshihen në analizë. Një kufizim tjetër lidhet me qasjen, pasi NSI mund të vëzhgojë artikuj dhe postime të publikuara që në 1 dhjetor 2023.

Mediat e vëzhguara që raportojnë nga Kosova në gjuhën serbe:

Alternativa, Gračanica Online, Radio Kontakt Plus, Kosovo Online, KoSSev, Medija Centar, TV Most, Radio Kim, Radio Mitrovica Sever, Radio Televizioni Gračanica, dhe RTK2

Periudha e vëzhgimit:

1 - 31. dhjetor 2024

Numri i mediave online të vëzhguara:

126 duke raportuar në shqip dhe serbisht në Kosovë, 126 nga Serbia dhe 24 media ndërkombëtare.

Qëllimi i monitorimit:

Çrregullimet informative në internet dhe media sociale, duke përfshirë uebsajtet, portalet e lajmeve online, Facebook, YouTube, TikTok dhe Instagram në Kosovë me fokus në hapësirën informative të serbëve të Kosovës.

Temat specifike të vëzhguara:

Shpërthim në hidrosistemin Ibër-Lepenc, protestat e udhëhequra nga studentët në Serbi, procedurat e certifikimit të partive politike para zgjedhjeve në Kosovë

Gjetjet kryesore

- Peizazhi mediatik mbetet i ndikuar ndjeshëm nga narrativat etnike, ku mediat serbe dhe shqiptare shpesh paraqesin versione kontradiktore të ngjarjeve.
- Liderët politikë dhe institucionet vazhdojnë të jenë nxitësit kryesorë të retorikës përçarëse, duke forcuar tensionet në vend të dialogut.
- Disa media nga Serbia promovojnë narrativa që delegjitimojnë institucionet demokratike dhe amplifikojnë raportimet e bazuara në frikë.
- Pasqyrimi i incidenteve që ndërlidhën me sigurinë bëhet sensacion dhe portreizohet në baza etnike.
- Termat nxitës ndaj komunitetit shqiptar vazhdojnë të përdoren në mediat nga Serbia, duke minuar përpjekjet për një dialog konstruktiv.
- Postimet dhe artikujt që ndërlidhën me identitetin kombëtar dhe sigurinë kanë tendencë të kenë angazhim më të lartë.

Rezultatet e monitorimit


Gjatë periudhës raportuese, media më aktive që raporton në gjuhën serbe ishte Kosova Online, e cila ka publikuar 2831 artikuj me 43,644 angazhime. E njëjta faqe ka regjistruar edhe më së shumti angazhime në rrjetet sociale.

Në periudhën raportuese, mediat në gjuhën serbe në Kosovë raportuan më së shumti për zhvillimet parazgjedhore në lidhje me përpjekjet e mocionit të anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga Vetvendosje për të ndaluar pjesëmarrjen e partisë më të madhe politike serbe të Kosovës, Listës Srpska, në zgjedhjet e ardhshme parlamentare në shkurt 2025. Vendimi i KQZ-së, i pasuar nga reagimi negativ i SHBA-ve dhe BE-së dhe thirrja e tyre për të lejuar pjesëmarrjen e të gjitha partive, u raportua në 38 artikuj, pasur nga nga konferenca e Listës Srpska, ku u njoftua për ankesën ndaj vendimit të KQZ-së për moscertifikimin e kësaj partie për zgjedhjet parlamentare (23 artikuj).

Së fundi, vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për të anuluar vendimin e KQZ-së, bazuar në ankesën e Listës Srpska dhe urdhri për ta certifikuar këtë parti, u raportua në 18 artikuj në mediat në gjuhën serbe në Kosovë, duke e bërë këtë zhvillim temën më dominuese në dhjetor. Pavarësisht kësaj, tema nuk pati shumë jehonë në audiencën e Facebook-ut, ku festat fetare mbeten ndër temat më të preferuara nga publiku që ndjek mediat në gjuhën serbe në Kosovë.

Që nga maji 2024, raportimi i mediave në gjuhën serbe ka parë një rënie të përgjithshme në nivelet e angazhimit. Megjithatë, në nëntor u regjistrua një rritje e ndjeshme e angazhimit të audiencës në Facebook në mediat në gjuhën serbe nga Kosova, për t'u ulur më pas në dhjetor të viti 2024 në nivelin më të ulët të matur që nga dhjetori i vitit 2023.


Artikujt e popullarizuar në gjuhën serbe në Facebook



Nuk pati mbivendosje në temat më të raportuara në mediat në gjuhën serbe dhe shqipe në Kosovë. Tema më e raportuar në gjuhën shqipe në Kosovë, me 447 artikuj të shkruar për të në dhjetor, ishte bastisja e shtëpisë së ish-Ministrit të Drejtësisë dhe Zëvendëskryeministrit të Kosovës, Hajredin Kuçi, me urdhër të Prokurorisë Speciale të Kosovës. Tema tjetër më e raportuar në mediat që raportojnë në gjuhën shqipe (349) ishte deklarata e Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, pas takimit të parë me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për politikën e jashtme, Kaja Kalas, e pasuar nga lajmi lidhur me aktakuzën e re ndaj ish-Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, për pengim të drejtësisë (348) dhe 336 artikuj të shkruar për aksidentin e trafikut që përfshinte një automjet të blinduar të Policisë së Kosovës në Veri. Temat që u trajtuan më së shumti nuk fituan angazhimin më të madh të audiencës.

Gjatë periudhës raportuese, media më aktive që raportoi në gjuhën shqipe nga Kosova ishte Bota Sot, e cila ka publikuar 10,214 artikuj me 55,757 angazhime. Megjithatë, faqja që regjistroi më shumë angazhime në rrjetet sociale ishte Indeks Online, me 211,232 angazhime, mbi 5,222 artikuj të publikuar në dhjetor.

Artikujt e popullarizuar në gjuhën shqipe në Facebook



Për herë të parë që nga dhjetori i vitit 2023, u regjistrua që artikulli individual me angazhimin më të lartë në Facebook ishte i pavërtetë. Lajmi që Besarta Jashari, një anëtare e familjes së njohur Jashari, ishte përfshirë në listën e kandidatëve të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) për zgjedhjet parlamentare në Kosovë, u mohua nga LVV.¹ Zëdhënësi i partisë akuzoi Klan Kosovën, portalin që publikoi lajmin, se po përpiquej të ndikonte në pritshmëritë e votuesve, në mënyrë që ata të zhgënjeheshin më vonë dhe përsëriti akuzat e shpeshta të partisë kundër këtij mediumi dhe dokumenteve të regjistrimit të pronarit të saj.

Ibër-Lepenci është një hidrosistem në Kosovë që furnizon ujë të pijshëm dhe ujë ftohës për termocentralet dhe mbështet bujqësinë në shtatë komuna. Kanali që kalon përmes zonave të banuara nga shqiptarët dhe serbët ishte objekt i një sabotimi të qëllimshëm që ndodhi në komunën me shumicë serbe të Zubin Potokut në veri të Kosovës në fund të nëntorit 2024. Ky incident, që përfshiu një shpërthim që e ka bërë të paafte kanalin të transmetojë ujë, ka rritur frikën për destabilizim mes mosmarrëveshjeve politike të vazhdueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke shkaktuar dënime në shkallë të gjerë nga vëzhguesit ndërkombëtarë. Pasi shpërthimi ndodhi në fund të nëntorit, tema vazhdoi të dominonte mediat edhe gjatë dhjetorit përmes deklaratave të zyrtarëve.

¹ <https://sinjali.com/besarta-jashari-u-raportua-se-do-te-jete-kandidate-e-vv-se-per-deputete-zedhenesi-e-mohon-e-pavertete/>

Pavarësisht pasigurisë, Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mbajti një konferencë shtypi vetëm disa orë pas shpërthimit, duke akuzuar drejtpërdrejt Serbinë dhe rrjetet kriminale serbe në Kosovë për kryerjen e sulmit. Akuzat e tij të shpejta rrezikuan përkeqësimin e tensioneve ndëretnike, por çdo trazirë e mundshme u kufizua kryesisht në komentet publike me urrejtje nga aktorë të ndryshëm. Kurti vazhdoi me të njëjtat akuza në dhjetor,² duke njoftuar për zbulimin e provave gjë që nuk ndodhi deri në fillim të vitit 2025. Përmes provave rrethanore, siç janë sendet e koleksionit si emblemat dhe uniformat e ushtrisë, duke përfshirë uniformat ceremoniale, kryeministri i Kosovës pretendoi se fajtorët pas sulmit ishin Serbia dhe Rusia, pavarësisht thirrjeve të SHBA-ve për të mos bërë akuza pa hetimin e duhur.³ Të njëjtat akuza u bënë edhe nga Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani..⁴

Po kështu edhe kabineti i Presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani,⁵ në lidhje me vendimin fillestar të KQZ-së për të mos certifikuar partinë më të madhe dhe më me ndikim të serbëve të Kosovës, Listën Srpska, për të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare, akuzoi partinë për përfshirje në akte terroriste. Nuk ka vendime gjyqësore apo procese që vërtetojnë këtë pretendim; në fakt, vendimi i KQZ-së është marrë përkundër disa institucioneve të tjera të Kosovës, përfshirë Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, të cilët rekomanduan që KQZ të certifikonte këtë parti në përputhje me ligjin.

Kurti gjithashtu bëri komente shqetësuese për disa media. Gjatë një mbledhjeje të Lëvizjes Vetëvendosje, Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mbajti një fjalim që nxiti kritika të ashpra nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK).⁶ AGK e dënoi deklaratën e Kurtit, duke e cilësuar si “gjuhë fyese dhe shumë të rrezikshme” drejtuar ndaj mediave. Në fjalën e tij, Kurti sugjeroi se disa media në mënyrë të vazhdueshme fajësojnë qeverinë e tij për veprimet agresive të Serbisë ndaj Kosovës, duke thënë se ato “nuk e meritojnë vëmendjen tuaj”. Ai gjithashtu nënkuptoi se kundërshtimi nga ana e mediave buron nga fakti që administrata e tij nuk i paguan ato dhe nga mungesa e frikës së qeverisë aktuale. AGK shprehu kundërshtim të fuqishëm ndaj kësaj retorike, duke theksuar se një qasje e tillë rrezikon sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve të mediave dhe i bëri thirrje Kryeministrit të ndalojë përdorimin e gjuhës që nxit urrejtje ndaj mediave.

Një tjetër temë që shpesh mbivendoset në hapësirën informative serbe dhe shqiptare është raportimi për Dhomat e Specializuara të Kosovës. Në dhjetor të vitit 2024, Presidenti i zgjedhur, Donald Trump, komentoi për Jack Smith, një

² <https://kossev.info/kosovo-online-najnovije-vesti-kurti-objavio-video-o-eksploziji-i-ogrtzuje-srbiju-i-rusije-petkovic-snima-animirane-filmove-i-bezi-od-odgovora/>

³ <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/hil-sad-i-srbija-imaju-razlicite-stavove-o-kosovu-ali-ne-smeju-da-do-zvole-da-ih>

⁴ <https://demokracia.com/osmani-ka-prova-konkrete-per-involvimin-e-serbise-ne-sulmin-ne-iber-lepenc/>

⁵ <https://kallxo.com/lajm/presidentja-osmani-thote-se-lista-serbe-eshte-angazhuar-ne-akte-terroriste/>

⁶ <https://kallxo.com/lajm/agk-reagon-pas-fjalimit-te-kurtit-e-cileson-gjuhe-te-rrezikshme-kunder-mediave/>

prokuror amerikan me përvojë të madhe në të drejtën vendore dhe ndërkombëtare, i cili shërbeu si Prokuror i Specializuar për Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) në Hagë nga 7 maji 2018 deri më 18 nëntor 2022. Gjatë mandatit të tij në DHSK, ai mbikëqyri hetimet dhe ndjekjet penale lidhur me krimet e pretenduara të luftës gjatë luftës në Kosovës, duke ngritur akuza ndaj personave si Salih Mustafa dhe ish-Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi.

Artikujt e publikuar nga disa portale në Kosovë⁷ raportuan për deklaratat e Presidentit të zgjedhur të SHBA-ve, Donald Trump, lidhur me Jack Smith, i cili, pas largimit nga Haga, gjithashtu e kishte hetuar Trumpin. Në një intervistë për NBC, Trump iu referua Smith si “i çmenduri Jack Smith” dhe sugjeroi se ai, pas rikthimit në Hagë, “mund të ekzekutojë njerëz” dhe është “i rrezikshëm edhe atje”.

Këto pohime janë faktikisht të pasakta dhe shtrembërojnë autoritetin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe DHSK-së. DHSK funksionojnë në bazë të një kornize ligjore të përcaktuar nga ligjet e Kosovës dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat nuk i japin as ZPS-së dhe as prokurorëve të saj fuqinë për të vendosur ose ekzekutuar dënime kapitale. Asnjë prej artikujve në fjalë nuk arrin të sqarojë këtë aspekt kritik, duke i shtyrë lexuesit të keqkuptojnë fushëveprimin e autoritetit të zotëruar nga Jack Smith dhe ZPS.

Kur bëhet fjalë për mediat nga Kosova që raportojnë në gjuhën serbe, Kosova Online gjatë dhjetorit ka ripublikuar një intervistë të Arnaud Gujon, drejtorit të Zyrës së Serbisë për Diplomaci Publike dhe Kulturore të botuar fillimisht nga Politika, e cila përmbante disa elemente që tregojnë dezinformim të mundshëm ose mungesë të kontekstit të duhur.

Artikulli me titullin “Gujon: Në dy vitet e fundit, 14% e serbëve kanë lënë veriun për shkak të presionit nga regjimi i Kurtit”⁸ përmban pretendime se “14% e serbëve janë larguar nga veriu i Kosovës në dy vitet e fundit”. Megjithatë, as artikulli dhe as Gujon nuk citojnë ndonjë burim zyrtar, raport apo të dhëna statistikore për të mbështetur këtë pretendim. Duke qenë se zonat me shumicë serbe në veri të Kosovës shpesh kanë bojkotuar regjistrimet e popullsisë, të dhënat e sakta demografike janë të vështira për t’u verifikuar. Artikulli gjithashtu përdor një gjuhë emocionalisht të ngarkuar, duke iu referuar qeverisë së Kosovës si “regjimi ekstremist i Kurtit” dhe duke i përshkruar politikat e saj si “ekstremizëm, nacionalizëm dhe urrejtje ndaj popullit serb”. Së fundi, artikulli përmend “113 sulme me motive etnike ndaj serbëve”, por nuk jep detaje specifike mbi natyrën e këtyre sulmeve, autorët e tyre (nëse ishin individë, grupe të

⁷ <https://www.gazetaexpress.com/trump-se-perjashton-mundesine-e-hetimit-te-jack-smith-i-cmenduri-ko-kthehet-ne-hage-ku-mund-te-ekzekutoje-njerez-eshte-i-rrezikshem-edhe-atje/> dhe https://nacionale.com/drejtisi/donald-trump-paralajmeron-kthimin-e-jack-smith-ne-hage-i-cmendur-mund-te-ekzekutoje-njerez-atje?utm_source=chatgpt.com dhe https://www.albinfo.ch/trump-i-cmenduri-jack-smith-eshte-duke-u-kthyer-ne-hage-mund-te-ekzekutoje-njerez-atje?utm_source=chatgpt.com dhe https://www.gazetatema.net/bota/donald-trump-per-jack-smith-i-cmenduri-ko-kthehet-ne-hage-aty-ku-mund-te-ek-1470655?utm_source=chatgpt.com

⁸ <https://www.kosovo-online.com/interviu/gujon-u-poslednje-dve-godine-14-odsto-srba-napustilo-sever-pod-protikom-kurtijevog>

organizuara apo raste nën hetim) dhe as reagimin e autoriteteve të Kosovës (nëse janë kryer arrestime, hetime apo nëse zyrtarët kanë dënuar këto sulme).

Sabotimi i qëllimshëm i kanalit Ibër-Lepenc ishte gjithashtu një temë e shfaqur me shpejtësi në mediat në Serbi lidhur me Kosovën. Ndërsa zyrtarët e Kosovës akuzuan Serbinë për sabotim pa prova, autoritetet serbe po ashtu akuzuan Kosovën për “orkestrimin”⁹ e incidentit dhe hetimit.

Për shembull, artikulli me titullin “Kurti ka humbur krejtësisht arsyen: Prishtina lidh sulmin e trilluar terrorist me sulmet ruse ndaj infrastrukturës në Ukrainë”¹⁰ përdor terma provokues si “humbur krejtësisht arsyen” dhe “sulum terrorist i trilluar”, duke synuar diskreditimin e Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe deklaratave të tij. Pretendimi i bërë nga Petar Petkoviç, Drejtori i Zyrës për Kosovë dhe Metohi të Serbisë, se sulmi ndaj kanalit Ibër-Lepenc ishte i trilluar, gjithashtu është bërë pa ofruar prova konkrete për ta mbështetur këtë. I njëjti ton dhe gjuhë fyese u vërejt edhe në artikullin e Alo me titull: “KURTI KA HUMBUR KREJTËSISHT MENDJEN! Kryeministri i rremë akuzon çmendurisht Serbinë, i referohet konfliktit në Ukrainë”.¹¹

Kurir shkoi edhe më tej, duke e akuzuar Kurtin se e kishte “paralajmëruar” incidentin në një intervistë të mëparshme për El Mundo¹² të Spanjës, ku ai kishte bërë një pohim të përgjithshëm se mund të ketë edhe incidente të tjera të sigurisë në Kosovë para zgjedhjeve.

Në nëntor të vitit 2024, një incident tragjik ndodhi në Novi Sad, Serbi, ku shembja e çatisë së një stacioni hekurudhor të saporenovuar rezultoi në vdekjen e 15 personave. Ky ngjarje nxiti protesta masive të udhëhequra nga studentët në mbarë vendin, ku demonstruesit kërkonin llogaridhënie dhe transparencë nga qeveria. Lëvizja u zgjerua me shpejtësi, duke përfshirë grupe të ndryshme shoqërore dhe duke ushtruar presion të konsiderueshëm politik mbi administratën e Presidentit Aleksandar Vuçiq. Pavarësisht disa lëshimeve nga qeveria, protestat vazhduan, duke theksuar pakënaqësinë e thellë publike ndaj korrupsionit sistemik dhe problemeve të qeverisjes.

Në mesin e këtyre demonstratave, disa media serbe publikuan artikuj që synonin diskreditimin e protestave duke pretenduar për ndërhyrje të jashtme, veçanërisht nga zyrtarë të Kosovës dhe Kroacisë. Për shembull, një artikull me titullin “Ja kush gëzohet për opozitën anti-serbe: Përkrahje e plotë nga Kurti për Marinika, Jeshiç, Gruhonjiç”¹³ pretendon se Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mbështet figurat opozitare serbe, duke nënkuptuar një përpjekje të përbashkët për destabilizimin e Serbisë.

⁹ <https://www.novosti.rs/vesti/politika/1435101/tako-ozbiljna-istraga-vodi-sve-bila-predstava-predsednik-vucic-ogolio-tzv-kosovske-vlasti-povodom-incidenta-zubinom-potoku>

¹⁰ <https://www.novosti.rs/vesti/politika/1435260/kurti-nacisto-lud-pristina-povezuje-izmisljeni-terroristicki-napad-ruske-udare-infrastrukturu-ukrajini>

¹¹ <https://www.alo.rs/vesti/kim/989797/kurti-je-potruno-poludeo-vest>

¹² <https://www.kurir.rs/vesti/politika/9512631/kurti-najavio-incident-u-zubinom-potoku>

¹³ <https://www.alo.rs/vesti/politika/994946/evo-ko-navija-za-antisrpsku-opoziciju-puna-podrska-kurtija-mariniki-jesicu-gruhonjicu-vest>

Një artikull tjetër, me terma veçanërisht fyese ndaj shqiptarëve dhe kroatëve, “Të pabesët sulmojnë nga të gjitha anët! Pas ustashëve, edhe ‘Šiptari’ Kurti dha mbështetje për ta vënë Serbinë në flakë”,¹⁴ e paraqet protestën studentore si të përkrahur nga armiq të jashtëm, duke vënë kështu në pikëpyetje legjitimitetin e motiveve të demonstruesve. Përveç kësaj, ky titull përdor një gjuhë tepër nxitëse, duke e barazuar protestën studentore me armiqtë historikë të Serbisë, si ustashët (lëvizja fashiste kroate gjatë Luftës së Dytë Botërore) dhe duke përdorur fyerje racore për shqiptarët.

Për më tepër, artikulli “A po i përdor Albin Kurti universitetet serbe për sulmet e tij hibride ndaj Serbisë: Cili është roli i Mila Pajiç?”¹⁵ sugjeron se udhëheqja e Kosovës po manipulon institucionet akademike serbe për të nxitur trazira, duke e shënjestruar në mënyrë specifike aktivisten Mila Pajiç si një bashkëpunëtore të supozuar.

Së fundi, artikulli me titullin “Kurti dha urdhrin personal: Mbrojtje policore për studentët ndërsa pikturojnë duar të përgjakura dhe frikësojnë popullin serb në Kosovë dhe Metohi” pretendon se Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka dhënë personalisht urdhër për mbrojtje policore të studentëve që angazhoheshin në aktivitete që supozohet se frikësonin komunitetin serb. Nuk ka asnjë provë që Kurti ka dhënë një urdhër të tillë, ndërsa pretendimi se studentët kanë pikturuar simbolet është plotësisht i rremë, pasi ky akt është kryer hapur nga aktivistët e një partie politike të serbëve të Kosovës që kundërshton Listën Srpska dhe Partinë Përparimtare Serbe.

Duke i lidhur liderët e protestave me zyrtarët e Kosovës, këta artikuj synojnë të dëmtojnë mbështetjen publike për lëvizjen dhe të largojnë vëmendjen nga çështjet kryesore të korrupsionit dhe qeverisjes që shkaktuan demonstratat.

Në përgjithësi, fyerje racore për shqiptarët është vërejtur në gjashtë artikuj në mediat në Serbi gjatë dhjetorit të vitit 2024. Në anën tjetër, nuk pati asnjë artikull që përmbante fyerje racore ndaj serbëve në mediat nga Kosova gjatë dhjetorit të vitit 2024, përveç në artikujt që raportuan mbi kërcënimet me vdekje ndaj gazetarit Berat Buzhala, ku personi që bëri kërcënimin e përdori këtë fjalë për ta fyer nënën e tij.

¹⁴ <https://informer.rs/politika/vesti/970925/aljbin-kurti-protesti-u-srbiji-podrska>

¹⁵ <https://www.novosti.rs/vesti/politika/1436281/aljbin-kurti-svoje-hibridne-naqade-srbiju-koristi-srpske-univerzitete-kakva-uloga-mila-pajic>

Ky raport është përgatitur nga Iniciativa e Re Sociale, një organizatë e shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut për të ndikuar përfundimisht në gjithëpërfshirjen, ndërtimin e besimit, proceset e demokratizimit dhe qeverisjen e mirë në Kosovë. Duke vepruar kështu, NSI ndjek vizionin e saj për një shoqëri gjithëpërfshirëse të ndërtuar mbi besimin dhe vlerësimin midis komuniteteve të saj, në të cilën qytetarët nga të gjitha grupet etnike marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe në qeverisjen e saj.